



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DHOMA KOMBËTARE E
NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER EDLIRA O. MALAJ
(GALANXHI)
ADRESA RR.SAMI FRASHERI,
PALLATI BLU PERBALLE
GJIMNAZIT PETRO NINI
LUARASI ,KATI 2
TEL: 694439947**

AKTI I THEMELIMIT

(AKT THEMELIMI I SHOQERISE)

Nr. repertori: 1555

Nr. koleksioni: 636

Tirane më 13/04/2022



Ligjet referuese:

- 1 Ligji nr. 7850, date 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2 .Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2022053010070737022



A2022053010070737022

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k.**

Sot, më datë 13.04.2022, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

THEMELUES:

Juliana Kërri, atësia Teki, amësia Sado, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në ROSKOVEC, me adresë Kuman Roskovec 01590027; Nd. 72; H. 2; Kuman; Kuman; 9315; Roskovec, lindur më 11/06/1993, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036086714 dhe nr. personal J35611020R.

E cila me dëshirën dhe vullnet të lirë e te plote, në mbështetje te neneve 39-53 te Ligjit nr. 7850, date 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikës se Shqiperise” i ndryshuar dhe te ligjit nr.8788 ,date 07/05/2001 me kerkoi redaktimin e Aktit te Themelimit si më poshte vijon;

NENI 1

STATUSI JURIDIK

Shoqëria Tregtare “EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË, VULA, THEMELUESIT

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k. Qendra ka vulen dhe logon e saj identifikuese, te cilat do te figurojne ne cdo dokument zyrtar te leshuar prej saj.

Themeluese e shoqerise si dhe ortake e vetme eshte:

Juliana Kërri, atësia Teki, amësia Sado, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në ROSKOVEC, me adresë Kuman Roskovec 01590027; Nd. 72; H. 2; Kuman; Kuman; 9315; Roskovec, lindur më 11/06/1993, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036086714 dhe nr. personal J35611020R.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i Veprimtarise së Shoqërisë do të jetë në:

Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi. Rivelimet topografike, punime topogjeodezike etj. Imp-eksport, tregti te mallrave te ndryshme. Punime dheu, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme e kompletimi me instalimet e nevojshme, ndertime civile, industriale, turistike, ndertim rruge, fusha aviacioni,veshje me asfaltobeton te rrugeve, ndertim veprash arti, ndertim ujesjellesash e kanalizime.Punime karpentjerie metalike, shpim pusesh gjeologjike inxhinierike e hidrogjeologjike etj. Ne fushen e Projektimit te ndertimit. Prova laboratorike ne strukturen ndertimore. Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri - porta e pontile. Konsulence Juridike, import-eksport mineralesh.Auditim ne finance dhe auditim ne ndertim. Hartim i raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, auditim mjedisor, hartim I ekspertizave per probleme mjedisore.Master plane studime plane rajonale urbanistike , plan rregullues te



A2022053010070737022

pergjithshem per qendra te banuara dhe qytete. Per Sherbime Espertize dhe/ose Profesionale lidhur me Burimet Energjitike. Import, eksport, shitje dhe blerje automjetesh per mallra dhe pasagjere. Vleresim i pasurive te paluajtshme, shitje, blerje pasuri e paluajtshme. Projektme dhe Studime Urbanistike. Projektme e ndertime civile, industrial turistike, bujqesore. Studime ambjentale, projektme interieresh, projektim peisazhi e sistemimi. Studime e projektme hidrogjeologjike, projektme rruge, ura, porte turistike, te inxhinierise elektrike, inxhinierise hidromekanike, projektme konstruktive restaurime si dhe konsulenca per temat e mesiperme. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim strukturash beton arme, metalike, projektim autostrada. Projektim linjash dhe sistemesh te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, ujesjelles kanalizime, vepra ujitje, kullimi impiante vaditese, diga dampa; projektim vepra naftesjelles, gazsjelles etj. Projektim fotogrametik, hartografik, topografik, konsulenca tekniko ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi qe nuk permendet me siper. Menaxhim dhe koordinim I projekteve te ndryshme, konsulenca te ndryshme ne lidhje me sherbimet e mesiperme

NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: Rr. Komuna Parisit, Hyrja 2, Tiranë, Shqipëri

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 90 000 000 (nentedhjetë million leke te reja), i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 90 000 000 (nentedhjetë million leke) te zoteruara teresisht nga ortaku I vetem Znj. **Juliana Kërri**.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7

ORGANET DREJTUESE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund te zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “**EDON CONSTRUCTION**” Sh.p.k, do te jete Znj. **Juliana Kërri**, identifikuar nga karta e identitetit me nr. I05506069Q, e cili zgjidhet për një periudhë 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara cdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8

LIGJI I APLIKUESHËM

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



A2022053010070737022

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUESE:
JULIANA KËRRI**

Juliana Kërrri

**NOTER
EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)**





STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE
“EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k.

Sot, në Tiranë, më datë 13.04.2022 (dymijë e njëzetë e dy), u paraqit personalisht ortaku themelues:
Juliana Kërri, atësia Teki, amësia Sado, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në ROSKOVEC, me adresë Kuman Roskovec 01590027; Nd. 72; H. 2; Kuman; Kuman; 9315; Roskovec, lindur më 11/06/1993, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036086714 dhe nr. personal J35611020R.

E cili ka themeluar shoqërinë “EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k dhe ka vendosur të nënshkruajë Statutin në përputhje me ligjin e ri që rregullon organizimin e shoqërive tregtare me terma si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare “EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë në:

Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi. Rivelimet topografike, punime topogjeodezike etj. Imp-eksport, tregti të mallrave të ndryshme. Punime dheu, tarracime, prodhim elementesh të parafabrikuara betoni e betonarme e kompletimi me instalimet e nevojshme, ndertime civile, industriale, turistike, ndertim rruge, fusha aviacioni, veshje me asfaltobeton të rrugëve, ndertim veprash arti, ndertim ujesjellesash e kanalizime. Punime karpentjerie metalike, shpim pusesh gjeologjike inxhinierike e hidrogjeologjike etj. Në fushën e Projektimit të ndertimit Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri - porta e pontile. Konsulencë Juridike, import-eksport mineralesh. Auditim në finance dhe auditim në ndertim. Hartim i raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, auditim mjedisor, hartim i ekspertizave për probleme mjedisore. Master plane studime plane rajonale urbanistike, plan rregullues të përgjithshëm për qendra të banuara dhe qytete. Per Sherbime Espertize dhe/ose Profesionale lidhur me Burimet Energjitike. Import, eksport, shitje dhe blerje automjeteve për mallra dhe pasagjere. Vlerësim i pasurive të paluajtshme, shitje, blerje pasuri e paluajtshme. Projektme dhe Studime Urbanistike. Projektme e ndertime civile, industriale turistike, bujqesore. Studime ambjentale, projektme interieresh, projektim paisazhi e sistemimi. Studime e projektme hidrogjeologjike, projektme rruge, ura, porte turistike, të inxhinierise elektrike, inxhinierise hidromekanike, projektme konstruktive restaurime si dhe konsulencia për temat e mesiperme. Studime urbanistike të të gjitha niveleve; planifikim urban, projektim arkitektonik, projektim strukturash beton arme, metalike, projektim autostrada. Projektim linjash dhe sistemesh të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, ujesjelles kanalizime, vepra ujitje, kullimi impiante vaditese, diga dampa; projektim vepra naftesjelles, gazsjelles etj. Projektim fotogrametik, hartografik, topografik, konsulencia tekniko ekonomike sipas kategorive dhe nenkategorive të licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi që nuk përmendet me sipër. Menaxhim dhe koordinim i projekteve të ndryshme, konsulencia të ndryshme në lidhje me sherbimet e mesiperme.

NENI 2

EMRI DHE SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj “EDON CONSTRUCTION” Sh.p.k.

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën: Rr. Komuna Parisit, Hyrja 2, Tiranë, Shqipëri.



NENI 3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe ka filluar me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 4

REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

Shoqëria është një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar (Sh.p.k.).

Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Biznesit.

Shoqëria ka vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

NENI 5

PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë dhe të lihen me trashëgimi me anë të vendimit të ortakëve.

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mos përmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do i shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në Nenin 1.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 90 000 000 (nentedhete million leke të reja), i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 90 000 000 (nentedhete million leke) të zotëruara teresisht nga ortaku I vetem **Znj. Juliana Kërri**.



NENI 8

PRONËSIA MBI KUOTAT

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 9

FITIMI OSE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 10

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

NENI 11

FONDET REZERVE

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 12

PËRDORIMI I TË ARDHURAVE NETO

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

NENI 13

BILANCI

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14

PLANI FINANCIAR

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.



NENI 16

KUFIZIMI I SHPËRNDARJEVE TË FITIMEVE

Shoqëria do të shpërndajë fitimet e ortakëve në çdo fund të vitit financiar, pas miratimit të bilancit nga Asambleja e Ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 17

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
6. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 18

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



• shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

• shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 19

THIRRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vëndin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 20

KUORUMI I NEVOJSHËM DHE VENDIM-MARRJA

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, kryhet me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

NENI 21

PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË ASAMBLESE

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vëndin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOOËRISË

NENI 22

ADMINISTRATORËT



Asambleja e përgjithshme emëron një ose deri në tre persona fizik si administratorë të shoqërisë.

Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e Administratorit do të përcaktohen në aktin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administrator i Shoqërisë “EDON CONSTRUCTION” ShPK, do të jete:

Juliana Kërri, atësia Teki, amësia Sado, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në ROSKOVEC, me adresë Kuman Roskovec 01590027; Nd. 72; H. 2; Kuman; Kuman; 9315; Roskovec, lindur më 11/06/1993, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036086714 dhe nr. personal J35611020R.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet, si dhe të përfaqësojë shoqërinë përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me pale të treta.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 23

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
7. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. Thërrasin asamblesë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

NENI 24

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORËVE

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 25



EKSPERTËT KONTABËL

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë.

Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar. Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

Ekspert Kontabel per shoqerine "EDON CONSTRUCTION" ShPK, do te jete:

Bledjon Marishta, shtetas Shqiptar, lindur në Gramshdhe banuese në Tirane, lindur më 17/01/1984, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr.

034666807 dhe nr. personal I401171750.

VI. MARRËDHENIET E PUNËS

NENI 26

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës. Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratave individuale ose kolektive të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.

NENI 27

PËRGJEGJËSITË E TË PUNËSUARVE

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VII. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI

NENI 28

PRISHJA E SHOQËRISË

Kjo Shoqëri do të prishet në rastet kur:

- 1.merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
- 2.hapen procedurat e falimentimit;
3. nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit";
4. merret një vendim gjykate.

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 29

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakeve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykate brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre.

Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë aksionare ndiqet nga shënimi "në likuidim".

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 30

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E LIKUIDUESIT

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 31

BILANCET

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 32

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve apo aksionarëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.

Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve.

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon c 'regjistrimin e shoqërisë.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 33

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 34


Çdo përcaktim që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


NENI 35

Ky Statut përpilohet në 4 (dy) kopje në gjuhën shqip, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKU THEMELUES

JULIANA KËRRI




NOTERE
EDLIRA MALAJ GALANXHI
NPT: L31322006A
TEL: 042 401041